

Në bazë të nenit 55 alinea 1 në Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të drejtorisë shtetërore (" Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 50 alinea 6 e Ligjit për arsim fillor (" Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.161/2019) Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli program të shkurtuar mësimorë për lëndën mësimore histori për klasat e IX në arsimin fillorë nëntëvjeçar.

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimorë për lëndën mësimore histori bazohet në qëllimet të parapara me programin për lëndën mësimore e cila realizohet në përputhje me planin mësimorë i miratuar për realizim në kushte të zakonshme.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara të cilat duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, me ç'rast respektohet fondi javor i orëve l përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht lënda mësimore me 2 orë në javë respektivisht 64 orë në vit sipas programit të shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore sipas programit të shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të përcaktuara në programin e rregullt mësimorë.

Lënda e historisë zë vend të rëndësishëm në procesin edukativo arsimorë në arsimin fillorë nëntëvjeçar për faktin sepse me te synohet që nxënësit të përvetësojnë dituritë themelore të sistematizuara dhe të vërtetuara në mënyrë shkencore. Ata duhet të fitojnë kuptime themelore për të kaluarën dhe të tanishmen e historisë dhe qytetërimeve dhe për etapat kryesore të tyre. Mësimi i historisë duhet të ndihmojë në krijimin e vetëdijes dhe qëndrimeve pozitive tek nxënësit për ngjarje të caktuara të historisë, për lëvizje e personalitete të ndryshme të cilët dallohen në përpjekjet e vazhdueshme për demokraci dhe për liritë të drejtat e njeriut.

Mësimi i historisë gjithashtu kontribuon në ndërtimin e sistemit të vlerave në drejtim të raportit ndaj popullit dhe shtetit të tij, ndaj popujve dhe shteteve tjera, të u ndihmon të rinjëve ta kuptojnë të tanishmen në dritën e të së kaluarës dhe gjithë asaj që paraqet e arritur civilizuese në frymën e vlerave qytetare dhe demokratike, si dhe ta thellojnë interesin e tyre për mësimin e mëtejshëm të ngjarjeve dhe proceseve historike.

1. Pasqyra e temave dhe e përmbajtjeve mësimore Преглед на теми и наставни содржини

Tema: Evropa, Ballkani dhe Maqedonia në Luftën e Parë Botërore 3+2=5

Tema realizohet me 3 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 2 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Përmbajtjet:

1. Lufta e Parë Botërore
2. Shtetet dhe vendet ballkanike në Luftën e Parë Botërore
3. Maqedonia në Luftën e Parë Botërore
4. Shqipëria në Luftën e Parë Botërore

Tema: Bota, Evropa dhe Ballkani ndërmjet dy Luftave Botërore 6+4=10

Tema realizohet me 6 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 4 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Përmbajtjet:

5. Bota pas Luftës së Parë Botërore
6. Turqia bëhet Republikë
7. Krijimi i Mbretërisë SKS
8. Bullgaria dhe Greqia ndërmjet dy luftave botërore
9. Shqipëria në periudhën e viteve 1918-1928
10. Mbretëria e Shqipërisë prej vitit 1928 deri në vitin 1939

11. Pozita e shqiptarëve në Mbretërinë e SHK
12. Rrethanat kulturore-arsimore të shqiptarëve nëpërmjet dy Luftërave Botërore

Tema: Maqedonia nëpërmjet dy Luftërave botërore 4+2=6

Tema realizohet me 4 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 2 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Përmbajtjet:

13. Maqedonasit në kuadrin të shteteve fqinje
14. Lëvizja nacional-çlirimtare maqedonase
15. Kushtetuta nacionale maqedonase në marrëdhëniet ndërkombëtare
16. Afirmimi i vetëdijes, gjuhës dhe të kulturës nacionale maqedonase

Tema: Bota, Evropa dhe Ballkani në Luftën e Dytë Botërore 5+4=9

Tema realizohet me 5 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 4 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Përmbajtjet:

17. Lufta e Dytë Botërore
18. Holokausti dhe pasojat gjatë Luftës së Dytë Botërore
19. Fuqitë e Boshtit dhe vendet ballkanike
20. Jugosllavia në Luftën e Dytë Botërore
21. Greqia në Luftën e Dytë Botërore
22. Bullgaria në Luftën e Dytë Botërore
23. Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore
24. Shqiptarët në Jugosllavi dhe Greqi në kohën e Luftës së Dytë Botërore

Tema: Maqedonia nw Luftwn e Dytw Botwrore 6+3=9

Tema realizohet me 6 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 3 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Përmbajtjet:

25. Okupimi dhe ndarja e Maqedonisw
26. Kryengritja e armatosur nw Maqdoni (1941)
27. LN^ nw Maqedoni (1942-1944)
28. ^lirimi i Maqedonisw dhe pjeswmarrja e maqedonaswve nw @lirimin e Jugosllavisw
29. Pozita e maqedonaswve nw Maqedoni dhe Bullgari (1941-1944)
30. Pozita e maqedonasve nw Greqi (1941-1944)
31. Krijimi i shtetit tw Maqedonisw

Tema: Bota, Evropa, dhe vendet ballkanike pas Luftws sw Dytw Botwrore 5+4=9

Tema realizohet me 5 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 4 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Përmbajtjet:

32. Marrwdhwniet ndwrkombwtare pas Luftws sw Dytw Botwrore
33. Ngritja dhe kriza e socializmit
34. Ndryshimet shoqwroro-ekonomike nw shtetet ballkanike
35. Shqipwria prej vitit 1944 deri nw vitin 1990

36. Shqiptarw nw Jugosllavinw e Avnojit dhe nw Greqi (1945 -1990)
37. Zhvillimi kulturoro-arsimor i shqiptarwve nw Jugosllavi
38. Jugosllavia dhe Shqipwria nw proceset pluraliste dhe demokratike

Tema: Maqedonia pas Luftws sw Dytw Botwrore 6+4=10

Tema realizohet me 6 orë përmbajtje të reja mësimore dhe me + 4 orë ushtrime dhe përsëritje. Ora mësimore është e planifikuar të zgjasë 30 minuta.

Pwrmbajtjet:

39. Rrethanat shoqwroro-politike dhe ekonomike nw Maqedoni
40. Pozita e pakicave nacionale dhe grupeve etnike nw Maqedoni pas Luftws sw Dytw Botwrore (1944-1991)
41. Maqedonia e pavarur dhe e mwvetwsishme
42. Kisha ortodokse maqedonase
43. Bashkwsia fetare islame dhe bashkwsitw tjera fetare nw Maqedoni
44. Arsimi, shkenca dhe kultura
45. Zhvillimi kulturorw e arsimorw i shqiptarwve nw Maqedoni (1944-1991)
46. Pozita e maqedonaswve nw shtetet fqinje
47. Mwrgata e Maqedonisw nw botw pas Luftwn e Dytw Botwrore

NGA 47 PWRMBAJTJE MWSIMORE ARSIMORE NW PLANIFIKIMIN E TYRE VJETORW DHE TEMATIK- PROCESUAL JANW TW OBLIGUAR TW REALIZOJNW 35 PWRMBAJTJE

2. Rekomandime didaktike

Realizimi i programit mësimorë të historisë i dedikuar për nxënësit e klasës së VI mbështetet parasegjithash në mundësitë zhvillimore, moshës, aftësitë dhe interesat e nxënësve. Përmbajtjet mësimorë mësohen nëpërmjet historisë së jetës së përditëshme, kulturës, traditave e jo nëpërmjet luftërave. Mësimdhënësi i nxit nxënësit që të njihen dhe t'i kuptojnë proceset historike, ndërkaq nuk insiston në mbamendje të fakteve të të gjitha datave për periudhën e caktuar historike.

Ky program mësimorë është i strukturuar në mënyrë që të nxitë tek nxënësit zhvillim të integruar në të kuptuarit e zhvillimit shoqërorë në periudha të caktuara historike, ndërkaq qëllimet, përmbajtjet dhe aktivitetet janë të komponuar për ndërlidhje reciproke të përmbajtjeve të caktuara me lëndët mësimore të grupit të shkencave shoqërore (gjuhë amëtare, arsim figurativ, muzikorë, gjeografi, shoqëri, arsim qytetarë etj.).

Rekomandimet për fondin vjetorë të orëve janë të dhëna vetëm si orientim së bashku me qëllimet konkrete dhe temat/përmbajtjet. Mësimdhënësi i lëndës gjatë realizimit të programit nuk është i kufizuar në shpërndarjen e temave dhe përmbajtjeve, pra ate mund ta bëjë në përputhje me nevojat dhe rrethanat e caktuara duke u mbështetur në kreativitetin vetanak në përdorimin ndryshe të orëve sipas vlerësimit të të arriturave të nxënësve të tij d.m.th sipas ndryshimit në kualitetin e diturive dhe aftësive të cilat i arrijnë ata (nxënësit).

Mësimdhënësi do të shfrytëzojë mjete ndihmëse mësimore të cilat janë të parashtruara në programin e rregullt mësimorë.

Sipas qëllimeve të parashtruara të programit mësimorë, mësimdhënësi gjatë procesit mësimorë rregullisht i ndjek dhe i vlerëson dituritë dhe të arriturat e nxënësve si dhe i siguron dëshmitë për aktivitetet e tyre, motivimin për mësim etj. Kjo komponentë është pjesë përbërse e themelore e planifikimit të mësimdhënësit për mësim dhe mësimnxënie. Për kontrollimin dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve në kuadër të materialit dhe temave mësimore të parashtruara në programin mësimorë, mësimdhënësi duhet patur parasysht komponentet vijuese: të shprehurit me gojë, prezentimet, fletëzat mësimore, kuizet, loja me role, debate, ese etj.

4. Normativi për kuadrin mësimorë

Program i shkurtuar mësimorë e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin për kuadrin mësimorë të përcaktuar në programin e rregullt mësimorë.

Programin e shkurtuar mësimorë për lëndën mësimore histori për klasën e IX në arsimin fillorë nëntëvjeçarë për vitin shkollorë 2020/2021 e miratoi

Ministri

Milla Carevska